



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT	
MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE	
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT	
Mjësia Org. Org. Jedin Org. Unit	Nr. Prof. Br. Prof. Prof. No:
01	1699
Nr. i faqes Broj strana No. pages	Data: Datum: Date:
5	15.10.20
PRISHTINE/A	
NO.1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Vushtrrisë

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministrastvo Ekonomije i Životno Sredine
Ministry of Economy and Environment

Prishtinë, / 10 / 2020
Nr. _____

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI/BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AMBIENTIT

DHE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	933/20
Nr. i fq. / Br. st	-05-
Data: / Datum	16.10.2020
VUSHTRRI - VUČITRN	

KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Prishtinë 2020

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/1 Mars 2019, duke u bazuar në nënin 8 të Rregullores (QKR), Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregullorën (QKR) Nr.m 07/2020 për Plotsimin dhe Ndryshimin e Rregullorës (QKR) Nr 06/2020, në nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Ligjin nr. 07/l-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 07 Gusht 2020), palët nënshkruese lidhin këtë:

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT

Furnizim me Pajisje të TI për Shkollat e Mesme

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e përfaqësuar nga Ministri i MEA-së (në tekstin e mëtejme MEA),

dhe

2. Komuna e Vushtrisë e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

Neni 1 Qëllimi

1.1.Qëllimi i kësaj Marrëveshje është financimi i projektit “**Furnizim me Pajisje të TI për Shkollat e Mesme**”, si dhe përcaktimi i obligimeve të Ministrisë dhe Komunës për realizimin e projektit.

Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e Bashkëfinancimit

1. MEA financon këtë projekt në vlerë prej: 10,000.00 € në vitin fiskal 2020..
2. Komuna e Vushtrisë do të financojë këtë projekt përtej shumës së financuar nga MEA.

Neni 3 Obligimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

1. MEA-ja i zotën mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.

2. Pagesat për bashkëfinancimin e projektit **“Furnizim me Pajisje të TI për Shkollat e Mesme ”** nga MEA, do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës, përveç avansit.

3. MEA cakton një zyrtar monitorues lidhur me këtë projekt, i cili monitoron projektin nga fillimi deri në përfundim të kontratës dhe në momentin kur i vëren parregullsitë apo defektet gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MEA-së.

Neni 4 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna obligohet që t’i krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit **“Furnizim me Pajisje të TI për Shkollat e Mesme ”** për operatorin ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesa të filloj implementimin (furnizimin) e projektit me kohë si dhe të siguroj specifikacionin teknik.

2. Komuna obligohet që projektin **“Furnizim me Pajisje të TI për Shkollat e Mesme ”** realizoj në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik dhe të Ligjit Nr. 04/L-194 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.

3. Komuna e kryen procesin e tenderimit, cakton komisionin e hapjes dhe vlerësimit të tenderit.

4. Komuna emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik;

5. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasitë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

6. Komuna obligohet që të njoftoj MEA-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, dhe për këtë të kërkoj pëlqimin e MEA -së.

7. Komuna obligohet që pajisjet e TI të i vendos në hapësirat e Shkollës/ave të Mesme, në Komunën e Vushtrrisë.

8. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga ana e MEA -së, të kompletoj këto dokumente :

8.1 Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara).

8.2 Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare, të verifikuar nga origjinali prej menaxherit të prokurimit të komunës.

8.3 Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës.

8.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara).

8.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MEA.

8.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

9. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që shuma e buxhetit e ndarë për këtë projekt sipas nenit 2.1 të kësaj marrëveshje, të realizohet gjatë vitit buxhetor 2020.

10. Komuna është e obliguar të njoftoi MEA për rrjedhat e realizimit të projektit sipas progresit të punimeve deri në përfundim të projektit.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1.Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MEA -së, dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MEA -ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i ka përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 6

Zgjidhja e marrëveshjes

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 7

Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8

Pronësia e projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kalojë në pronësi të Komunës.

2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 9
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Blerim Kuçi,
Ministër i MEA-së



Xhafer Tahiri,
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

